



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 207 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot më datë 15.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 207 Akti, datë 30.04.2020, si më poshtë:

Kërkues: **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

Objekti: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 189, datë 04.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Baza ligjore: Neni 479/a dhe 615/a i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **AMG sh.p.k.**

I paditur: **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 3459 (80-2016-3454), datë 04.07.2016 ka vendosur: “- Pranimin e pjesshëm të padisë. – Detyrimin e palëve të paditura që t’i paguajnë paditësit dëmin pasuror në shumën 5.296.892 Lekë. –

Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera të saj. – Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 189, datë 04.02.2020** ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 3459 (3454), datë 04.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; - Detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë palës paditëse shumën 1.498.692 Lekë si fitim të munguar. – Lënien në fuqi të vendimit për disponimet e tjera. – Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 189, datë 04.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj.

4. **Me datë 30.04.2020 Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm kanë nisur sipas njoftimit të përmbaruesit;*
- *Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Agjencia Kombëtare e Ushqimeve ka realizuar detyrat e saj të inspektimit në bazë të ligjit dhe se njohja e çertifikimit nga ana e autoriteteve turke vdo të vlente vetëm për ngarkesat e ardhshme dhe jo për sasinë e mallit të kontrolluar nga pala e paditur;*
- *Pala e paditur nuk mund të linte subjektin të fuste në territorin e Republikës së Shqipërisë sasinë e mallit pa kontrollin e nevojshëm;*
- *Nuk rezulton nga dosja gjyqësore që të ketë dokument të paditësit të dorëzuar për vërtetimin e kontrollit veterinar të produkteve me origjinë shtazore;*
- *Lejimi i ngarkesës është bërë nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural vetëm për të mos lejuar incident diplomatik ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë;*
- *Nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi civile pala e paditur për vonesat e ndodhura nga kontrolli i ligjshëm mbi sasinë e mallit që kërkohej të futej në territor;*
- *Fitimi i munguar nuk është përcaktuar sipas të dhënave të marra nga pasqyrat financiare, pasi në dosje nuk ka të tilla dhe se nuk provohet kjo pjesë e demit sikurse ka pretenduar pala paditëse;*
- *Akti i ekspertimit nuk bazohet në provat e fashikullit të gjykimit dhe për rrjedhojë nuk mund të përdoret në proces;*
- *Përgjegjësia për shkaktimin e demit është e palës paditëse në këtë rast, pasi ai duhet të kishte plotësuar detyrimin ligjor për dorëzimin e njoftimit paraprak dhe çertifikatës së shëndetësisë;*
- *Bllokimi nuk është kryer me Urdhrin nr. 790, datë 28.01.2015 të Ministrit në kushtet kur çdo informacion merret nga AKU, pasi këto kompetenca lidhen dhe janë në përgjegjësinë e AKU;*
- *Ka qenë e pamundur të gjenden prova për të provuar ngjarjen, pasi ka ndodhur në vitin 2015 dhe se drejtorët dhe nëpunësit janë ndryshuar disa herë;*
- *Detyrimi financiar i ngarkuar nga gjykatat për dëmshpërblim është i madh dhe se ekzekutimi i tij do t’i shkaktonte dëm shtetit, pasi nuk mund të ktheheshin prapa këto shuma nëse vendimi ekzekutohet dhe rekursi gjendet i bazuar në ligj nga Gjykata e Lartë;*
- *Vendimi titull ekzekutiv duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë..*

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar e më tej ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së

Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

6. Me datë 11.05.2020 shoqëria AMG sh.p.k. ka parashtruar pretendimet e saj mbi kërkesën për pezullim. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Kërkesa nuk plotëson kushtet e nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;*
 - *Nuk janë argumentuar dhe nuk janë provuar pasojat e rënda që vijnë nga ekzekutimi i vendimit;*
 - *Garancia që ofron neni 485/a i Kodit të Procedurës Civile është e mjaftueshme për pretendimet që paraqet kërkuesi;*
- Kërkesa për pezullim nuk duhet të pranohet.*

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuenin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Koncretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuenin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur debitore e titullit ekzekutiv është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Shkaqet e paraqitura në të dublojnë shkaqet e paraqitura në rekurs dhe se për pasojë nuk mund të zgjidhen në këtë gjykim nga ana e Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkesa nuk bazohet në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kundër Vendimit nr. 3459 (80-2016-3454), datë 04.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ndryshuar me Vendimin nr. 189, datë 04.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, me datë 15.05.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.169 Rregj.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Sot më datë 15.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 169 Prot., datë 16.01.2020, si më poshtë:

Kërkues: **Gjimnazi “Naim Frashëri” Durrës**

Objekti: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. (82-2018-816) 367, datë 25.05.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, të ndryshuar me Vendimit Nr. 2311 (86-2019-2650), datë 29.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **Znj. Mimoza Çelçima**

I paditur: **Gjimnazi “Naim Frashëri” Durrës
Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës
Inspektoriati Shtetëror i Arsimit Durrës**

Person i tretë: **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me Vendimin Nr. (82-2018-816) 367, date 25.05.2018** ka vendosur ndër të tjera: “1. Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit, Mimoza Çelçima, me të paditur Drejtoria e Gjimnazit “Naim Frashëri”, Durrës, Drejtoria Arsimore Rajonale, Durrës, Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, me person të tretë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. 2. Detyrimin e të paditurit, Drejtoria e Gjimnazit “Naim Frashëri”, Durrës, të zbatojë Vendimin nr. 11, datë 26.01.2016 të Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi, duke kthyer paditësen në vendin e mëparshëm të punës. 3. Detyrimin e të paditurit, Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, t’i paguajë paditësit nga data e ndërprerjes deri në kthimin në punë pagat e pathëna, duke kryer pagimin e kontributeve dhe mbajtjet tatimore nga paga. 4. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin Nr. 2311 (86-2019-2650), datë 29.07.2019** ka vendosur: “- Ndryshimin e pjesshëm të Vendimit nr. 367 (82-2018-816), datë 25.05.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe rrëzimin e kërimit të paditëses, Mimoza Çelçima, për detyrimin e të paditurit, Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës për pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë. – Lënien në fuqi të Vendimit nr. 367 (82-2018-816), datë 25.05.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës për disponimet e tjera të tij.”.

3. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me date 26.12.2019, ka ushtruar rekurs pala e paditur, Zyra Arsimore Rajonale Durrës, Gjimnazi “Naim Frashëri” Durrës, e cila kërkon ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë.

4. **Me datë 16.01.2020 pala e paditur gjyqumbëse dhe njëkohësisht debitore ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e vendimit të formës së prerë,** duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave të faktit janë haptazi në kundërshtim me provat dhe me ligjin;
- Pala paditëse nuk ka respektuar disiplinën në punë dhe për këtë arsye është hequr nga detyra;
- Gjykatat kanë gabuar kur kanë përcaktuar detyrim bashkësolidar ndërmjet të paditurve, duke mos përcaktuar se sa është detyrimi i gjithësecilit;
- Nuk është respektuar parimi i ndarjes së pushteteve, duke mos arsyetuar vendimin gjyqësor;
- Gjykatat nuk mundet ta rikthenin në punë palën paditëse;
- Nga ana e shërbimit përmbartimor ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv;
- Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë mundet të shkaktojë dëme me efekte financiare të konsiderueshme;
- Vendimet e gjykatave të faktit duhet të pezullohen derisa çështja të shqyrtohet në Gjykatën e Lartë.

5. Rezulton se ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit gjyqësor të shndërruar në titull ekzekutiv.

6. **Me datë 05.02.2020 pala paditëse, znj. Mimoza Çelçima, ka paraqitur parashtrimet e saj kundër kërkesës për pezullim.** Në to parashtrohet se:

- Kërkesa është e pabazuar në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;
- Kërkesa nuk plotëson kushtet formale, pasi nuk përmban stemën, emërtimin e organit shtetëror, datën dhe numrin e protokollit;

- Nuk legjitimohet Gjinnazi të paraqesë kërkesë për pezullim, pasi nuk është subjekt juridik më vete;
- Nuk ka në kërkesë as shkaqe për pezullim dhe as prova;
- Në kërkesë ka shkaqe të cilat janë paraqitur në rekurs dhe se për rrjedhojë kërkesa është e papranueshme;
- Kolegji Administrativ duhet të vendosë mospranimin e kërkesës.

7. Me datë 06.05.2020 pala paditëse ka paraqitur para Gjykatës së Lartë një parashtrësë në të cilën bëhet me dije se me Vendimin nr. 2, datë 30.04.2020 të Drejtorisë së Gjinnazit “Naim Frashëri” Durrës është vendosur ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke e rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, si mësuese definitive, në të njëjtat kushte punësimi që pala paditëse kishte para zgjidhjes së marrëdhënies së punës. Bashkëlidhur kësaj parashtrëse ndodhet edhe vendimi për të cilën pala paditëse ka realizuar parashtrimin. Për rrjedhojë pala paditëse kërkon që të vendoset mospranimi i kërkesës për rishikim, pasi nuk ka më shkak ligjor dhe objekt pezullimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

11. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor,

respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

12. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimit nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

13. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

14. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përlegjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Në këtë çështje nuk ka as prova dhe as argumente konkret që pala kërkuese të bazojë pretendimet e saj.

16. Për më tepër, në rastin konkret pala e paditur, edhe pse ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë duke pretenduar se ekziston një rrezik i pakthyeshëm, gjatë pritjes për një vendimmarrje nga ana e Gjykatës së Lartë, ka vendosur të ekzekutojë titullin ekzekutiv, duke e kthyer palën paditëse në vendin e mëparshëm të punës. Ky fakt do të thotë se nuk ka pasur një rrezik të pakthyeshëm që palës debitore do t'i vinte nga ekzekutimi i vendimit titull ekzekutiv dhe se për më tepër sot kjo kërkesë ka mbetur pa objekt, duke qenë se titulli ekzekutiv është ekzekutuar. Kolegji vlerëson se ekzekutimi i vendimit gjyqësor titull ekzekutiv në këtë rast ka bërë që të bie një ndër kushtet për legjitimitimin e caktimit të masës së përkohshme procedurale, konkretisht rrezikut të një dëmi të pakthyeshëm. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këto arsye:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile,

Vendosi:

Mospranimin e kërkesës së Gjimnazi “Naim Frashëri” Durrës për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. (82-2018-816) 367, datë 25.05.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 2311 (86-2019-2650), datë 29.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, me datë 15.05.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 210 i Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot më datë 15.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 210 dhe 211 Regjistri, datë 08.05.2020, si më poshtë:

Kërkues: Avokatura e Shtetit
Agjencia e Trajtimit të Pronave

Objekti: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 255 (86-2018-3638), datë 16.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: Z. Jani Nathanaili

I paditur: Agjencia e Trajtimit të Pronave

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Rrethanat e çështjes

1. Në këtë çështje ka për gjykim dy kërkesa për pezullim të paraqitura së bashku me rekursin e secilës pale kërkuese dhe rekursuese. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 55, 57, 159, 448 dhe paragrafi i fundit i nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se konstatoi gjatë gjyqimit se ekzistojnë edhe elementet

subjektive dhe objektive të koneksitetit ndërmjet tyre dhe se ato janë ushtruar ndaj të njëjtit vendim, vendosi të bashkojë shqyrtimin e kërkesave në një çështje të vetme.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 255 (86-2018-3638), datë 16.12.2019** ka vendosur: “- *Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit Jani Nathanaili. – Shfuqizimin e vlerësimit financiar të kryer nga pala e paditur, Agjencia e Trajtimit të pronave, për vendimin nr. 784, datë 16.11.1996 të ish KKKP Bashkia Tiranë të ndryshuar, duke detyruar palën e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, të bëjë vlerësimin financiar për sipërfaqen 324 (treqind e njëzet e katër) m2 për zërin kadastral truall sipas përcaktimeve të VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë. – Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera.”.*

3. Pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit kanë ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor dhe duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Bashkë rekursit janë paraqitur edhe kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

4. **Në aktin e rekursit pala e paditur, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, kanë paraqitur në Gjykatën e Lartë dy kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në këto kërkesa parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs dhe pritet të vendosë Gjykata e Lartë;*
- *Gjykata e apelit ka shkelur nenin 17 dhe 37 të Ligjit nr. 49/2012 dhe se Ligji nr. 133/2015 nuk është respektuar për sa i përket përllogaritjes dhe llojit të zërit kadastral që duhet të vlerësohet prona e ish-pronarit;*
- *Ekziston domosdoshmëria e marrjes së masës së pezullimit, pasi ka urgjencë dhe se ngarkimi i palës së paditur me këtë detyrim financiar do të rrezikonte funksionimin e institucionit;*
- *Vendimi përfundimtar në këtë çështje, sipas Ligjit nr. 133/2015, është vendimi i Gjykatës së Lartë për sa kohë që është ushtruar rekurs;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka gjykuar menjëherë kërkesën për pezullim, pa pritur dhe pa urdhëruar më parë që të procedohej me njoftim të posaçëm për kërkesën për pezullim. Kolegji vlerësoi të mjaftueshme për dijeninë e palës paditëse vetë momentin e njoftimit të rekursit, duke qenë se kërkesa për pezullim është e ndërfutur në rekurs në këto rast. Për rrjedhojë nuk ka nevojë që në këto raste të procedohet me njoftimin e posaçëm sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile mbi kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit është

e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, premisën e parë të bazueshmërisë në ligj ka objektin, që do të thotë vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret objekti i kërkesës nuk rezulton të jetë vendim gjyqësor i formës së prerë.

14. **Së pari**, sipas nenit 451 shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Civile parashikon se:
“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

...ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”.

15. Në rastin konkret Gjykata Administrative e Apelit, sipas nenit 29 të Ligjit nr. 133/2015, e ka gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, duke ushtruar juridiksion fillestar.

16. **Së dyti**, sipas nenit 5 pika 17 e Ligjit nr. 133/2015 “Vendim përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtuar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë. Më tej neni 30 i Ligjit nr. 133/2015 parashikon se:

“1. Kur vendimi i marrë, sipas këtij ligji, bëhet përfundimtar, Agjencia ose çdo palë e interesuar e dërgon atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrim.

2. Për vendimet që nuk u është dhënë formë e prerë, për shkak të ndryshimeve të ligjit, Agjencia verifikon nëse është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, në rast të kundërt, këto vendime konsiderohen të formës e prerë.”.

17. Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor objekt rekursi në këtë rast nuk është i formës së prerë. Për rrjedhojë kërkesa nuk duhet të pranohet për gjykim. Përsëritja nga ana e kërkesit e një kërkesë të tillë në të ardhmen do të përbëjë shkak ligjor për zbatimin e sanksionit procedural të parashikuar nga pika 1 e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këto arsye:

*Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012
“Për gjykimin administrativ dhe gjykatat administrative dhe Nenin 479 të Kodit të
Procedurës Civile,*

Vendosi:

Mospranimin e kërkesës së Agjencisë së Trajtimit të Pronave dhe Avokaturës së Shtetit për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 255 (86-2018-3638), datë 16.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, me datë 15.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI